Kultura përfaqësuese e Shqipërisë Verilindore, Kolshi i ka si tregues themelor qeramikën barbotine në relief të ngritur, qeramikën e piktuar me bojë kafe mbi sfond të kuq dhe qeramikën impreso të cilat vendosen mjaft qartë në raporte kulturore e kronologjike me Rudnikun (Rudniku III) në Rrafshin e Dukagjinit dhe me gjithë kulturat e fazës Starçeve IIb të Ballkanit Qendror. Blazi I e II në zonën e Matit ka qeramikë të tipit impreso-kardium me motive të ndryshme si edhe qeramikë njëngjyrëshe gri e të zezë me shkëlqim që i japin kulturës së këtij vendbanimi shpellor karakterin adriatik lindor (Smilcic I).

Neoliti i mesëm. Kalimi nga neoliti i hershëm në neolitin e mesëm shënon një kthesë në të gjithë zhvillimin kulturor të territorit të vendit tonë, gjë që është pasqyruar mjaft qartë në kulturat: Dunavec I-Cakran Blaz III, të cilat përfaqësojnë dhe tri fazat kryesore të zhvillimit të neolitit të mesëm në Shqipëri. Tipar themelor për të gjitha




Fig.3: Qeramike e Neolitikut me të hershem (faze Podgorie)

fazat e kësaj periudhe është qeramika ngjyrë gri, gri e zezë dhe e zezë me sipërfaqe të lëmuar me ose pa shkëlqim, si edhe qeramika barbotine e impreso të trashëgura nga neoliti i hershëm. Qeramika shquhet për një larmi formash ku mbizotërojnë kupat bikonike me variante të ndryshme, tasat trung konikë me fund të lartë, enët me trup sferik me profile të ndryshme të qafës e të buzës si edhe forma të tjera me përdorim të kufizuar. Qeramika e neolitit të mesëm dallon edhe pasurinë e zbukurimeve të bëra me incizim e thellim, hera-herës të inkrustra me bojë të kuqe ose të bardhë, për zbukurimet plastike variantesh të ndryshme, për zbukurimin me kanelyra, me pikturim etj.

Cdo njera nga tri kulturat përfaqësuese ka tiparet dhe veçoritë lokale që burojnë nga diferenca në kronologjinë relative si edhe nga pozita gjeografike nga raportet e lidhjet që ati kishin me kulturat fqinjë.

Faza Dunavec I që përfaqëson shtresën më të hershme të neolitit të mesëm është e lidhur me ekzistencën e një vendbanimi palafit i cili, sot për sot, është më i hershmi në territorin e Ballkanit. Në Dunavecin i, krahas qeramikës së zezë, gri të zezë të cilësisë shumë të mirë vazhdon të përdoret gjërësisht qeramika barbotine me relief të zhvilluar, traditë kjo e neolitit të hershëm Starçevian. Por tonin kulturës së Dunavecit I ia japid format e reja të enëve dhe zbukurimet në relief, zbukurimet me incizim e ngulitje, zbukurimet me kanelyra, pikturimi gri etj.

Gjatë Dunavecit II, krahas elementeve që u trashëguan nga periudha paraardhëse, dhe këto përbëjnë shumicën, ka edhe një tog elementesh të reja që e veçojnë atë si një fazë më vete. Zbukurimi në relief njeh zhvillimin e tij më të gjërë, po ashtu bëhet tipik zbukurimi me gjërvishtje i tipit adriatik, kanelyra përmirësohet cilësisht dhe krahas pikturnimit gri, del edhe qeramika e pikturnuar me bojë të kuqërrremitë. Në këtë fazë shfaqen edhe fragmentet e para të qeramikës dyngjyrëshe kuq e zi.

Cakrani dhe Dunaveci II kanë përputhje të plotë kulturore e kronologjike. Për t'u shënuar është gjetja në Cakran e disa fragmenteve enësh të pikturnara dhe në Dunavec II e një fragmenti, të cilat janë të importuara nga kultura Thesalike e Diminit të hershëm (faza Arapi). Ato japid një datë të saktë për ekzistencën e njëkohëshme të Cakranit e Dunavecit II me Arapi dhe në të njëjtën kohë dëshmojnë për zhvillimin e këmbimit midis trevave tona me Thesalinë. Edhe kultura e Kolshit II në territorin e Shqipërisë Verilindore gjendet përputhje të plotë me atë të Cakranit (fig. 4).




Fig.4: Qeramike e Neolitikut te Rrëshen (faza Maliq-Kamnik)

Faza fundore e neolitit të mesëm është dëshmuar sot nga Blazi III në territorin e Shqipërisë së brendshme qendrore. Ajo karakterizohet nga qeramika ngjyrë gri, gri e zezë e ngjyrë kafe e zbukuruar me motive linearo-gjeometrike e spiralike të cilat janë elemente karakteristike për kulturat danilike të bregdetit dalmatin. Krahas tyre ka edhe enë të zbukuruara me ornamente me vija të thelluara të cilat mjafë mirë e vënë në raporte kulturore e kronologjike me kulturën Lisiçiq (Hvar) të neolitit të vonë të Adriatikut.

Kulturat e neolitit të mesëm të vendit tonë kanë edhe disa tregues të rëndësishëm të kultit e të botës shpirtërore. Si shfaqje e re dhe kryesore janë ritonet, enë jo të zakonshme me katër këmbë me grykë ovale të vendosur pjerrtas me një dorezë të madhe në pjesën e sipërme të trupit dhe të lyera me bojë të kuqe (fig. 5). Ekzemplarë të ritoneve janë gjetur qysh në fillim të fazës Dunavec I e do të vazhdojnë të gjenden gjérësisht gjatë tërë ekzistencës së vendbanimit të Dunavecit, të Cakranit e të Kolshit II, me një shumëllojshmëri në zgjidhjen plastike të këmbëve me ose pa zbukurime. Këto ritone sipas mendimit të shumë studjuesve duhet të kenë shërbyer në ceremoni rituale kushtuar kulteve të rëndësishme, siç ishte ai i pjellorisë së tokës, të gruas ose të gjësë të gjallë, kulte që ishin të lidhura me riprodhimin e jetës, me pjellorinë e tokës e të bagëtisë të cilat ishin degët bazë të ekonomisë.

Ritonet i gjemjë të bëra me të njëjtat forma, përmasa e të lyera me bojë të kuqe ose zbukurime me incizim, në një territor të gjerë të Ballkanit Perëndimor e Jugor që fillon nga Spliti (Danilo) në Veri e deri në Korinth në Jug (Elateia) kurse në zonën e brendëshme nga Bosnja Qendrore (Kakanji), në Kosovë (Reshtan), në pellgun e Korçës (Dunavec) e deri në Thesali (Drahmani). Ky fakt nuk ishte rastësi, por shprehje e një kulti i cili bashkonte bashkësitet e shumta heterogjene të njerëzve të neolitit të zhvilluar në një hapsirë të gjërë.

Një kult tjetër i fuqishëm i njohur nga vendbanimet bashkëkohëse të Ballkanit është ai i Magna-Mater (Tokës mëmë) i cili është dëshmuar në Dunavecin I e II nga një koleksion shumë i pasur figurash antropomorfe prej balte të realizuara me mjafë art si edhe nga ato të Cakranit e Kolshit II. Së fundi vlen të përmendim se në Cakran, në Rudnik (Kosovë), në Obre I (Bosnjë) e në kultura të tjera bashkëkohëse të Ballkanit në vendbanime janë gjetur skelete fëmijësh në pozicion kruspull, dëshmi e një kulti flijimi me qëllim mbrojtjeje të vendbanimit ose me qëllim tjetër.

Neoliti i vonë. Kalimi nga neoliti i mesëm në neolitin e vonë është bërë nëpërmjet një evolucioni të ngadaltë e shkallë-shkallë. Kështu




Fig.5: Riton i Neolitikut te mesem

neoliti i vonë në pellgun e Korçës është përfaqësuar në tërë shtrirjen e tij kohore nga tri faza suksesive Dërsniku, Barç II dhe Maliq Ia.

Faza Barç II karakterizohet nga qeramika me tone të çelëta okër në të verdhë dhe më rrallë të kuqërrëmtë, nga qeramikë kafe e murme si edhe nga qeramikë gri të zezë e trashëguar nga neoliti i mesëm. Gjatë tërë ekzistencës së vendbanimit vazhdon të përdoret në sasira të vogla qeramike "black topped" (kuq e zi) si edhe zbukurimet plastike me prejardhje nga faza paraardhëse, kurse pikturimi me bojë kafe i cili sa shfaqet në Dunavecin II fillon të shtohet numerikisht në mënyrë të dukshme dhe vetëm në fazën pasardhëse Maliq Ia qeramika e pikturuar arrin kulmin e zhvillimit të saj duke u bërë edhe tipari më i qënësishëm për kulturën e Maliqit I. Enët karakteristike si kupat gjysmësferike ose ato konike, vazot sferike e bikonike me qafë të shkurtër, enët trung konike, "frutieret" me këmbë të lartë, vazot antropomorfe etj., janë të pikturuara me bojë kafe, vishnjë, të kuqe, portokalle, me zbukurime të larmishme lineare-geometrike dhe meadro-spiralike dhe në tërësiato dallojnë për teknikën e pastër të punimit për pjekjen e plotë, për elegancë formash dhe ekzemplarë të veçantë mund të konsiderohen si prodhime të poçerisë artistike. Në territorin e vendit tonë një kulturë plotësisht e njëjtë është zbuluar në shtresën e parë të vendbanimit të Kamnikut në rrethin e Kolonjës (fig. 6+7).

Kulturat përfaqësuese neolitike të vendit tonë, nga ajo më e hershmja e Vlushës në mijëvjeçarin e shtatë p.e.sonë e deri tek Malqi I, mesin e mijëvjeçarit të katërt p.e.sonë, dëshmojnë për një vijimësi banimi për një jetë sedentare që u kushtëzua nga lindja dhe zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë. Vazhdimesia e jetës dhe e traditës gjen shprehjen e vet në shtimin e madh të veglave të punës prej stralli guri e kocke dhe mbi të gjitha në përsosjen e teknikës së punimit të tyre, të dëshmuara këto në koleksionet e pasura të veglave të punës në Vashtëmi, Podgorie, Dunavec, Maliq I etj., të cilat u bënë faktor përcaktues edhe në zhvillimin e dukshëm të forcave prodhuese. Gjithashtu shpikja dhe futja në përdorim të gjerë e punimit të enëve prej balte, krahas përsosjes së teknikës së tjerrjes dhe endjes, ishin arritje të mëdha të njeriut neolitik që e bënë atë shumë më të




Fig.6: Qeramike e Neolitikut te Ri



Fig.7: Qeramike e Neolitikut te mesem (faze Dumavec)

pavarur nga mjedisë. Tipar i ri i rëndësishëm i epokës ishte lindja e marrëdhënieve të këmbimeve. Këtë e provojnë importet e mirëfillta thesalike të gjetura në Kolsh I, në Dunavec II, në Cakran e në Maliq I si dhe prodhimet identike të ritoneve të figurave antropomorfe.

Kulturën eneolitike të Shqipërisë e njohim sot nga zbulimet e bëra në vendbanimin e Maliqit, Trenit, Burimasit, Kamnikut, Bënjës, Nezirit, Blazit, Gradecit etj. Në kronologjinë absolute përfshin afërsisht vitet 3500-3000 p.e.sonë, kurse në kronologjinë relative përfaqësohet nga tri faza zhvillimi: eneolit i hershëm, i mesëm dhe i vonë.

Bakri i hershëm ose faza Burimas është përfaqësuar nga vendbanimi i Burimasit dhe nga shtresa kulturore e Maliqit Ib e Kamnikut II. Në Maliq e Kamnik shtresa kulturore e neolitit të hershëm është depozituar drejtpërdrejt mbi shtresën kulturore të neolitit të vonë, pa asnjë ndërprerje stratigrafike dhe me një bashkëjetesë të elementeve të periudhës paraardhëse me atë pasardhëse. Në Maliq vendbanimi është vendosur në fushë pranë lumit Devoll, kurse në Burimas, Kamnik dhe Gradec të Dibrës ato janë të vendosura në kodra relativisht të ngritura e që kanë mbrojtje natyrore mjaft të mirë.

Tipari më i rëndësishëm i fazës Burimas, është qeramika gri e zezë dhe e zezë me shkëlqim e cila bëhet mbizotëruese ndaj gjithë llojeve të tjera. Ajo do të vazhdojë të përsoaset më tej gjatë eneolitit të zhvilluar e të vonë duke u bërë tipari më i qënësishëm i tërë poçerisë eneolitike. Në eneolitin e hershëm format e enëve janë të thjeshta. Kupa variantesh të ndryshme, tasa trung konikë, pjata si edhe enë sferike me grykë të ngushtë e qafë të shkurtër të traditës neolitike. Qeramika e zezë e gri e zezë ka edhe zbukurimet e veta karakteristike, si zbukurimin me incizim me vija të thelluara me motive lineare gjeometrike që formojnë shirita të gjerë ose trekëndësha të mbushur me pika, dy ose tre vija paralele, një radhë pikash ose gropëzash, spirale ose kombinime të tjera më të rralla. Ka edhe enë të zbukuruara me shirita të incizuar dhe breza të lyer me bojë të kuqe. Fragmentet me zbukurime të bëra me gërvishtje të lehtë janë të rralla.

Tipar tjetër karakteristik për eneolitin e hershëm dhe që e veçon atë prerasi nga neoliti i vonë është pikturimi gri i cili në fillim të jetës së vendbanimit është shumë i rrallë, po vjen e shtohet shkallë-shkallë e përmirësoset cilësisht. Motivet janë të thjeshta: vija të drejta, tufa vijash paralele që shkojnë pjerrtas ose priten me vija të tjera. Pikturimi gri në të gjithë treguesit stilistiko-dekorativë të kujton të njëjtin stil të neolitit të mesëm. Një tipar të tretë e karakteristik për Burimasin përbën zbukurimi me shirita të lyer me bojë të kuqe ose të bardhë të vendosur në buzë të pjatave ose të tasave, nga jashtë ose nga jashtë e brenda.

Gjetje me interes janë edhe pak fragmente enësh të pikturuara me grafit të importuara nga kulturat eneolitike të Ballkanit Lindor e që dëshmojnë për

këmbimet me këto treva. Si vazhdim i traditës së neolitit të vonë në fazën Burimas vazhdoi të jetë në përdorim qeramika dyngjyrëshe, kuq e zi dhe me një numër shumë të kufizuar qeramika e piktuar me tone të celëta e neolitit të vonë.

Eneoliti i zhvilluar është përfaqësuar në mënyrë të plotë nga Maliqi IIa i cili emërton me të drejtë fazën më të rëndësishme të epokës së bakrit. Fillimet e jetës në Maliqin Iia janë të lidhura me një vendbanim të tipit palafit (fig. 6) i cili është zbuluar në një sipërfaqe të madhe, kurse më vonë, me ndryshimin e kushteve të terrenit banesat u ngritën drejtpërsëdrejti mbi tokë. Për t'u shënuar është edhe fakti se në shtresën kulturore të Maliqit II, të trashë 2.50m me një shtrirje mjaft të gjërë, është gjetur një lëndë arkeologjike nga më të pasurat në vendbanimet historike e cila ka krijuar mundësi të gjera për t'u njojur më shumë anë të veprimtarisë së banorëve eneolitikë të Maliqit. Veglat e shumta të punës prej stralli, guri të lëmuar, kocke, briri, balte (pesha për rrjetat e peshkimit e të tezgjahut vertikal) si dhe veglat prej bakri (sëpatat e tipit daltë, bizat, gjilpërat, grepat e peshkimit), formojnë tablonë e zhvillimit shoqëror ekonomik të kohës.

Nga të gjithë treguesit kulturorë, qeramika është ajo që karakterizon dhe individualizon fazën Maliq IIa: Së pari, ajo bart një tog elementesh që janë të traditës së hershme eneolitike, si qeramikën e zezë e gri të zezë, format kryesore të enëve, teknikat e njëjtë të zbukurimit, si piktuimi gri, me bojë të kuqe ose të bardhë, zbukurimet me incizim etj. Së dyti, elementet e reja që vijnë si evolimi i elementeve të trashëguara, por që si rezultat i zhvillimit të mëtejshëm fitojnë cilësi të reja, ose elementet që lindin në këtë fazë. Kështu ndër format e enëve më të njoitura janë kupat me profile të larmishme, midis të cilave janë kupat me profil s-je forma të reja e tipike janë kupat me grykë eliptike; enët trung-konik me grykë të gjërë e një vegje të vogël poshtë saj, enët sferike ose dykonike pa qafë “vazot e qumshtit”, pjatancat me buzë të kthyera nga brenda, tavat, çerepet, filxhanët me ose pa qafë si edhe kapakët konikë e cilindrikë. Zbukurimet janë të shumëllojshme dhe të realizuara me cilësi. Kryesore mbetet piktuimi, incizimi dhe zbukurimet plastike.

Edhe neoliti i vonë është i përfaqësuar më mirë në vendbanimin e Maliqit nga shtresa kulturore Maliq IIb, po ai është i dëshmuar mjaft mirë edhe nga vendbanimi fqinj i Trenit (Treni I), nga Neziri I në Mat, nga Gradeci në Dibër, Bënja I në Përmet si edhe nga gjetje të rastit në pikë të ndryshme të vendit, të cilat në shtrirjen gjeografike mbulojnë pjesën më të madhe të territorit të vendit tonë.

Faza Maliq IIb stratigrafikisht dhe në të gjithë treguesit e saj është vazhdim drejtpërdrejt i fazës Maliq IIa. Ndryshimet me fazën paraardhëse të eneolitit të zhvilluar janë më shumë të karakterit sasior, por edhe të daljes nga qarkullimi të disa elementeve dhe të futjes në përdorim të elementeve të reja. Kështu, në Maliqin IIb, bëhen karakteristike amforat me shpatulla të fryra me dy vegje të

vogla, çanakët me qafë të shkurtër, kupat e cekëta me qafë e shpesh të zbukuruara me kanelyra, pjatat e shtrira me buzë të kthyera nga brenda, poçet bikonike me dy vegje vertikale në buzë, filxhanët me një vegje shumë të tèrhequr mbi shpatulla. Për t'u përmendur është edhe një filxhan i tipit “baden”. Zbukurimet e fazës Maliq IIb përgjithësisht vazhdojnë të janë po ato të Maliqit Ia, por ka edhe ndryshime. Zbukurimi me incizim zhvillohet më tej; shtohen zbukurimet plastike kurriore, kanelyrat janë të shumëllojshme e të bëra me cilësi të lartë.

Kultura e epokës së bakrit e Maliqit shquhet edhe për një pasuri e larmi objektesh kulti. Vendin e parë e zenë figurinat antropomorfe skematike në formë kryqi, por jo më pak karakteristike janë edhe figurinat antropomorfe steatopigjike me krahë të cunguara të cilat në realizimin ikonografik janë të njëjtë me figurinat e steatopigjike të Dunavecit.

Kultura eneolitike e vendit tonë u zhvillua në lidhje e marrëdhënie me kulturat bashkëkohëse ballkano-egjiane. Në të veç komponentëve vendas që u trashëguan nga neoliti i vonë, ka edhe elementë të kulturave kontinentale (Bubanj Hum-Salkuca-Krivodol), elemente të kulturave tesalike (Rahmani) si edhe elemente të Adriatikut Lindor.

Kultura e epokës së bakrit e vendit tonë si vazhduese e drejtpërdrejtë e kulturës neolitike ishte në të njëjtën kohë vazhduese e qytetërimit neolitik në të gjitha aspektet. Bujqësia dhe blektoria u zhvilluan më tej. Koleksionet e pasura të veglave të punës e sasirat e konsiderueshme të grurit të karbonizuar të gjetura në Maliqin eneolitik, janë dëshmitë më të mira për një bujqësi të zhvilluar, kurse për përparimet e rolin e blektorisë dëshmojnë kockat e shumta të bagëtive të imta e të trasha. Në pikëpamje teknologjike qeramika njohu kulme të tjera progresi, deri në realizimin e prodhimeve prej balte me vlera artistike.

Numri relativisht i madh i veglave të punës prej bakri i zbuluar në Maliq e Kamnik është dëshmi e shkallës së zhvillimit të metalurgjisë së bakrit dhe punimit të tij në vend, gjë që është provuar edhe nga kallëpet e gjetura në Maliq. Zhvillimi i punimit të bakrit u favorizua nga ekzistanca e mineralit të bakrit në Rehovë të pellgut të Korçës.

Epoka e bronxit

Gjatë mijëvjeçarit të tretë p.e.sonë afërsisht rrreth viteve 2500-1100 p.e.sonë territori i vendit tonë u njoh me bronzin dhe përdorimin e tij në përgatitjen e armëve e të veglave të punës. Kjo epokë përfaqëson një nga periudhat më të rëndësishme të zhvillimit historik. Zbulimet e vendbanimeve të Maliqit (Maliqi IIIabcd) të Trenit (IIIa,b), të Gajtanit, të Belshit (Elbasan), të Nezirit (Mat), të Bënjos (Përmet), në Podgorie (Korçë), si edhe të një varg varrezash tumulare, si në Pazhok (Elbasan), në Barç (Korçë), në Vajzë (Vlorë), në Vodhinë (Dropull), në Shkrel e Shtoj (Shkodër), Bajkaj (Sarandë), Piskovë (Përmet), Patos (Fier)

etj. Kanë bërë të mundur të ndiqet zhvillimi kulturor i vendit tonë gjatë epokës së bronzit në tri periudha: bronzi i hershëm, i mesëm dhe i vonë.

Periudha e bronzit të hershëm. e cila quhet ndryshe edhe periudha e kalimit nga eneoliti në bronzështë e dëshmuar nga Maliqi IIIa,b, Treni IIIa, Gajtani I, Neziri III, Bënja II, si edhe nga varret më të hershme të tumave të Pazhokut, të Vajzës, të Bajkajt, të Shkrelit, të Shtojit e të Piskovës.

Në vendbanimin e Maliqit shtresa kulturore e bronzit të hershëm është depozitar pa asnjë ndërprerje mbi shtresën kulturore të eneolitit. Ajo karakterizohet nga një qeramikë, në përgjithësi, me tipare primitive ku format kryesore të enëve janë ato me dy vegje shiritore mbi buzë, enë profilesh të ndryshme me dy vegje nën grykë, sahanët me katër vegje unazore, kupëzat trungkonike me një vesh të brimuar mbi buzë, broket me trup të fryrë e qafë të lartë cilindrike me një vegje shiritore nën grykë etj. Qeramika e Maliqit IIIa është e zbukuruar me ornamente plastike me shirita me ose pa gropëza të thelluara me grupëzime të bëra mbi buzë ose poshtë saj si edhe me zbukurim pseudobarbotin. Shfaqja në mënyrë të menjëhershme e kësaj qeramike trashanike në fillimin e epokës së bronzit tregon se kemi të bëjmë me ardhjen e një popullsie të re nga lindja, e cila nuk e zhduku popullsinë eneolitike, por u përzie e bashkëjetoi me të. Dëshmi e vazhdimesisë e banimit nga popullsia eneolitike janë enët me profil s-je, pjatat me buzë të trashura nga brenda si edhe zbukurimet me kanelyra, zbukurimet me incizim si edhe terrakotat antropomorfe kryqyforme, peshat e rrjetave të peshkimit si edhe shumë vegla pune prej guri, kocke e briri të traditës eneolitike. Kështu, në formimin e kulturës së bronzit të hershëm morën pjesë dy përbërës kryesorë ai autokton eneolitik dhe përbërësi i ardhur nga lindja si rezultat i dyndjes së popujve indoevropianë.

Në fazën Maliq IIIb të bronzit të hershëm vendin e qeramikës trashanike e pseudobarbotine e zuri një qeramikë e punuar mirë, e cila pasurohet me elemnate të reja që zhvillohen në vend e në lidhje të ngushtë me kulturat fqinjë bashkëkohore të Maqedonisë e të Thesalisë.

Në krahinën e Shkodrës kultura e bronzit të hershëm, krahas elementeve të përbashkëta që ka me bronzin e hershëm të zonës së Matit dhe me atë të Shqipërisë Juglindore paraqet disa veçori lokale. Në shtresën kulturore të Gajtanit I, në shtresën më të hershme të kalasë së Shkodrës si edhe në varret më të hershme të Shkrelit e të Shtoit janë gjetur me shumicë fragmente qeramike e forma tipike enësh, si broka të tipit Kotorac, enë njëvegjake me qafë cilindrike e buzë të gjera të zbukuruara me ornamente të incizuara të stilit Cetina, enë me një vegje në trajtë x-i etj. Nga këto dëshmi arkeologjike rezulton se zona e Shkodrës, në kohën e bronzit të hershëm, duhet të ketë qenë në lidhje të ngushtë me zonat adriatike qendrore dhe prapatokat e saj (fig. 7).

Një dukuri e re shumë e rëndësishme për bronzin e hershëm të vendit tonë është shfaqja e ritit të varrimit në tuma. Ky rit që zë fill në këtë periudhë në territorin e Ballkanit Perëndimor përhapet gjatë periudhës së bronzit të mesëm, asaj të bronzit të vonë dhe parapëlqehet gjithnjë e më shumë. Në epokën e hekurit bëhet një nga ritet kryesore të popullsisë ilire. Sot për sot tumat më të hershme në territorin e vendit tonë janë tuma 1 e Pazhokut, tuma 1 e Piskovës e pak më të vona tuma 1 e Barçit e tuma e Shkrelit.

Periudha e bronzit të mesëm. është periudha e formimit të plotë të kulturës së bronzit në të gjithë përbërësit e saj. Futja në përdorim të gjerë e armëve e veglave të punës të përgatitura prej bronzi si edhe situata e qetë u shoqëruan me një zhvillim të mëtejshëm të bujqësisë e blektorisë si edhe me përparime gjithnjë në rritje të veprimtarisë metalurgjike për të cilën flet edhe një kallëp guri për derdhje, gjetur në Maliq IIIc. Tregues të tjerë zhvillimi ekonomik e shoqëror të kohës janë shfaqja e qeramikës lluksoze, e armëve të importuara nga Mikena të cilat dëshmojnë për diferencimin shoqëror, por edhe për intensifikimin e këmbimeve ndërkrahinore.

Periudha e bronzit të mesëm është përfaqësuar mjafë mirë nga shtresa kulturore e Maliqit IIIc, nga vendbanimi shpellor i Bënjës e i Nezirit, nga vendbanimi i Cetushit si edhe nga varrezat tumulare të Vodhinës, të Bajkajt, të Vajzës, të Pazhokut, të Matit etj.

Në Maliq shtresa kulturore e bronzit të mesëm vjen menjëherë pas asaj të bronzit të hershëm pa asnjë ndërprerje kronologjike e kulturore. Ndryshimi i qeramikës së Maliqit IIIc me Maliqin IIIb është më shumë i natyrës teknologjike.

Qeramika ka pasur ngjyra përgjithësisht të errëta, gri në të zezë, me forma enësh të modeluara më mirë me sipërfaqe shpesh të lëmuar dhe me shkëlqim të dobët. Midis formave më karakteristike kanë qenë enët me vegje të gjerë gjysmërrethore që ngrihen mbi buzë, enët me një vegje "with bone", enët me vegje në formë teh sëpate të vendosur me një farë largësie nga buza e enës, tenxheret me dy vegje horizontale të vendosura pjerrtas nën grykë, kupat bikonikë me dy vegje të larta shiritore mbi buzë të tipit pseudominoik. Me vlerë të veçantë kronologjike janë enët me vegje të ngritura lart të cilat në zbritje ngjiten në pjesën e brendshme të fundit të enës, të gjetura në Maliq IIIc, Bajkaj e Vodhinë. Zbukurimet e qeramikës së bronzit të mesëm janë të thjeshta dhe kryesisht të traditës së periudhës së mëparshme, si shirita plastikë shpesh me shtypje, në formë nervurash, thimthash, pullash etj.

Kuadrin kulturor të periudhës së bronzit të mesëm na e plotëson në shumë anë inventari i varreve të kësaj periudhe i cili kryesisht përbëhet nga shpata, kama, thika e majë heshtash prej bronzi. Në përgjithësi ato riprodrojnë tipet

armësh egjeane tē periudhës sē mesme heladike dhe tē hershme mikenase me ndonjë variant tē lehtë lokal. Kështu, ndër armët më tipike tē gjetura në territorin e vendit tonë, mund tē përmendim një shpatë tē gjatë tē tipit Egjean (rreth shek.XVI p.e.sonë) (fig. 8), tē gjetur në Vajzë, shpatën e Pazhokut me dorezë tē brirëzuar, tē gjetur së bashku me një filxhan balte tē tipit "vafio" (shek. XVI p.e.sonë); një shpatë tjetër tē ngjashme me atë tē Pazhokut tē gjetur në Midhë në Mat, dy kama bronzi tē gjetura në Vodhinë e Pazhok; disa majë heshtash në formë pantofle etj. Periudhës sē bronzit tē mesëm i takojnë thikat me prefëse tē harkuar, tē gjetura në Mat, Pazhok e Vajzë tē cilat vazhdojnë tē përdoren gjatë tërë periudhës sē bronzit tē vonë. Prania e importeve tē armëve kreto-mikenase dhe tē enëve tē luksit dëshmojnë përmarrëdhënien tē ngushta tregtare që ekzistonin midis territorit tē vendit tonë e botës së Egjeut. Ato flasin përmarrëdhënien tē aristokracisë fisnore e cila këmbente prodhimet e asaj me prodhimet më tē përparuara tē kohës.

Ndër objektet metalike tē bronzit tē mesëm vlen tē përmendim edhe një kamë tē gjerë trekëndëshe prej bronzi tē gjetur në Vajzë, e cila imiton modele italike dhe si e tillë flet përmarrëdhënien tē këmbime që ekzistonin qoftë edhe tē kufizuara, midis dy brigjeve tē Adriatikut.

Periudha e bronzit tē vonë. Përfaqëson periudhën e lulëzimit më tē madh tē kulturës së bronzit, periudhën e zgjerimit tē mëtejshëm tē prodhimit në shumë degë tē ekonomisë, e në mënyrë tē veçantë tē përpunimit tē metaleve. Ajo është e përfaqësuar nga shtresa kulturore e Maliqit IIId, e Trenit IIIb, e Podgories, e Belshit I, e Bënjës II, e Badhërës si edhe nga varrezat tumulare tē Pazhokut, Barçit, Matit, Vajzës, Vodhinës, Bajkajt, Patosit, Piskovës etj. Kuadrin kulturore tē kësaj periudhe e plotësojnë edhe shumë gjetje tē rastit me shtrirje në tërë territorin e vendit tonë.

Në periudhën e bronzit tē vonë, bronzi hyri gjëresisht në përgatitjen e veglave tē punës e tē armëve duke i kufizuar në maksimum përdorimin e veglave prej guri e kocke. Kjo erdhi si rezultat i përmirësimit tē teknikës së nxjerrjes së punimit tē metaleve. Përmirësime tē dukshme u bënë edhe në punimin e enëve prej balte.

Qeramika e bronzit tē vonë, ndonëse ruante një tog elementesh tē punimit tē qeramikës së bronzit tē mesëm, dallohet qartë nga ajo e Maliqit IIIc, përmarrëdhënien tē cilësi



Fig.8: Vendi prehistorik i Maliqit



Fig.9: Terrakota balte te epokes se hershem te bronzit

më të lartë: e pjekur më mirë, me ngjyra kryesisht të çelëta, si bezhë, ngjyrë tulle e nuanca të saj, ngjyrë gri etj., me pasuri formash. Nga format më të zakonshme të bronzit të vonë janë enët me dy vegje shiritore të zhvilluara, enët me vegje brinake, me vegje biforata e "wish bone", amforat trung konikë me qafë të gjatë etj.

Një nga treguesit më të rëndësishëm të periudhës së bronzit të vonë të territorit të Shqipërisë Juglindore është qeramika e piktuar e stilit devollit. Ajo është një qeramikë e cilësisë shumë të mirë, e bërë nga argjil i pastër i pjekur plotësisht. Enët kanë sipërfaqe të lëmuar e shpeshherë të lustruar, me ngjyra të çelëta kryesisht okër ose të kuqërremitë. Format e enëve kanë përmasa të ndryshme e janë të modeluara mjafë mirë. Karakteristikë për qeramikën devollite është edhe piktuimi me bojë kafe, me motive gjimekrite e drejtvizore (fig. 9).

Kjo lloj qeramike është quajtur devollite, sepse lindi dhe u zhvilluanë pellgun e lumit Devoll. Ajo u shfaq për herë të parë në fillimet e bronzit të vonë dhe vazhdoi të zhvillohet e lulëzojë gjatë kësaj periudhe, madje në epokën e hekurit arriti shkallën më të lartë të cilësisë së punimit e të përhapjes territoriale më të gjerë.

Në zonën e Matit, të Shkodrës e të Kukësit gjatë periudhës së bronzit të vonë vazhdoi të mbetet në përdorim një qeramikë që i përbahet traditës së qeramikës së bronzit të mesëm, një qeramikë me tone të errëta e zbuluar me teknikën e incizimit. Megjithatë, mjaf forma enësh tipike të Devollit janë të njoitura edhe në qeramikën e Matit e Kukësit. Kështu, zë zonën e Shkodrës kultura e kësaj periudhe e përfaqësuar nga shtresa Gajtan II përbante forma dhe zbulime kryesisht të incizuara me motive gjimekrite.

Gjatë periudhës së bronzit të vonë e sidomos nga fundi i saj si rezultat i shtimit të prodhimit metalurgjik u rrit shumë numri dhe llojshmëria e objekteve metalike. Në Shqipërinë e Veriut u shfaqën dhe morën një përdorim të gjerë sëpatat prej bronzi me brirë të përforcuar me nervura në relief. Ato kanë origjinë orientale dhe tipologjikisht dallohen qartë dy tipa kryesorë: tipi i sëpatave shqiptaro-dalmate dhe tipi i sëpatave shkodrane. Gjatë viteve të fundit është rritur shumë numri i këtyre sëpatave në Shqipërinë e Veriut duke përfshirë edhe zonat e thella.

Kufirin më jugor të përhapjes së sëpatave shkodrane e përbënte Shelcani i Elbasanit, kurse Shijaku kufirin jugor të sëpatave shqiptaro-dalmate. Një nga depot më të mëdha të këtyre sëpatave është ajo e Torovicës në afërsi të Lezhës, ku janë gjetur 124 copë sëpata të tipeve të ndryshme. Duke marrë parasysh përhapjen gjeografike të tyre rezulton se zona e Matit dhe e Kukësit, e pasur me minerale bakri, duhet të ketë qenë një ndër zonat kryesore të prodhimit të tyre, por nuk përjashtohet mundësia që këto lloj sëpatash të janë punuar edhe në zonën e ulët të Shqipërisë Veriore. Këto lloj sëpatash që u shfaqën në fund të epokës së bronzit vazhduan të prodhohen e të qarkullojnë edhe më dendur në fillimet e epokës së hekurit (shek.XI-X p.e.sonë) jo vetëm si vegla pune, por edhe si paramonedha.

Gjatë periudhës së vonë të bronzit e fillimit të epokës së hekurit në territorin e Shqipërisë së Jugut u përhapën gjerësisht sëpatat dytehëshe prej bronzi të tipeve e të madhësive të ndryshme. Edhe pse riprodhoheshin tipa të njohur nga Greqia, Maqedonia etj., ato kishin tipare e veçanti lokale që tregojnë se edhe vendi ynë duhet të ketë qenë një nga qendrat e prodhimit të tyre. Format e armëve të tjera të periudhës së bronzit të vonë si shpatat me dorezë të brirëzuar (të gjetura në Mat, Gërmenj, Nenshat), kamat e shpatat me bazë të tehut trekëndëshe të pajisura me tri përcina, thikat e tipeve të ndryshëm etj., ishin të riprodhua nga ato të bronzit të mesëm (fig. 10). Me përhapje më të kufizuar ishin majat e heshtave në formë violine, ato me bisht prizmatik etj. Në fund të epokës së bronzit në vendin tonë u dukën për herë të parë edhe shpatat me dorezë në formë gjuhe, majat e heshtave në formë flakëze si edhe sëpatat e tipit kelt, të cilat kanë hyrë si rezultat i kontakteve me kulturat veriore, si rezultat i dyndjes panono-ballkanike.

Epoka e bronzit në territorin e vendit tonë karakterizohet nga një zhvillimi pandërprerë kulturor, nga një zhvillim i ngadaltë, por gjithnjë në rritje e me përparime të ndjeshme në degët kryesore të ekonomisë. Gjetjet e bollshme arkeologjike flasin për zhvillimin e metalurgjisë dhe procesin teknologjik të punimit të bronzit. Përparime të shënuara u bënë edhe në bujqësi me përdorimin e par mendës të tërhequr nga kafshët, me përmirësimin e veglave bujqësore. Edhe



Fig. 10: Heshta dhe thika te tipit Miken te epokes se vone te Bronzit

blektoria në jetën ekonomike të fiseve të veçanta po zinte vend qendor. Përparimet në metalurgji, në bujqësi e në blektori u shoqëruan me ndryshime të rëndësishme në marrëdhëni me shoqërore, ku krahas fuqizimit të rendit patriarchal, po lindte edhe një shtresë e re, aristokracia fisnore.

Këto ndryshime të rëndësishme shoqërore gjetën shprehjen e vet edhe në ngritjen e vendbanimeve në përputhje me kushtet e reja. Kështu krahas vendbanimeve të hapura, si të Maliqit, Belshit, e vendbanimeve shpelllore, si të Trenit, Nezirit, Bënjës etj., filluan të ngrihen edhe vendbanimet e fortifikuara me mure, si ai i Badhrës. Këto lloj vendbanimesh vendoseshin mbi kodra me pozicion zotëruesh dhe rrëthoheshin me mure të gjera të bëra me gurë të papunuar me lidhje të thatë. Ky tip vendbanimi u përhap, u zhvillua dhe u bë karakteristik për epokën e hekurit.